



MARRËVESHJE PARTNERITETI

PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT

Nënshkruar në..... më datë

Ndërmjet:

.....
(emri i plotë dhe adresa e **Aplikantit Kryesor**), që në këtë marrëveshje do të quhet
"Partneri kryesor",
i përfaqësuar nga:,
dhe

.....
(emri i plotë dhe adresa e institucionit të **bashkë-aplikantit**) si partner,
i përfaqësuar nga:,
dhe

.....
(emri i plotë dhe adresa e institucionit të **Partnerit të asociuar (të projektit)**) si
partner, i përfaqësuar nga:,
që në këtë marrëveshje do të quhen "Palët",

duke pasur parasysh udhëzimet për aplikantët të ofruara në Thirrjen për Aplikime
sipas Skemës së Granteve PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin;

Palët bien dakord për sa më poshtë:

§ 1. Objekti i marrëveshjes

1. Objekti i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i parimeve dhe procedurave të bashkëpunimit si dhe i detyrimeve të ndërsjella të Palëve në kuadër të partneritetit të krijuar me qëllim zbatimin e Projektit.....
..... (titulli i projektit) në kuadër të Skemës së Granteve PZHRSH për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin.
2. Për më tepër, kjo marrëveshje përcakton edhe kërkesat ndaj palëve për administrimin me korrektësi të projektit të grantit.



§ 2. Afati i Marrëveshjes së Partneritetit për Zbatimin e Projektit

1. Marrëveshja e Partneritetit për Zbatimin e Projektit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të gjitha Palët.
2. Zbatimi faktik i Marrëveshjes së Partneritetit për Zbatimin e Projektit fillon në datën e zbatimit të Projektit, siç përcaktohet nga kontratën e grantit.
3. Periudha e zbatimi të Projektit është muaj. Kjo marrëveshje do të vazhdojë deri sa të jenë përmbushur të gjitha detyrimet e Partnerit Kryesor, siç përcaktohet në kontratën e grantit.

§ 3. Të drejtat dhe detyrimet e Partnerit Kryesor

1. Partneri Kryesor përgjigjet para Autoritetit Kontraktues dhe Entit të Deleguar për koordinimin, administrimin dhe zbatimin në përgjithësi të Projektit. Në mënyrë të veçantë, ky partner është përgjegjës për të siguruar administrimin me korrektësi të Projektit nga të gjitha palët që janë pjesë e zbatimit të tij.
2. Partneri kryesor është organi i vetëm që ka të drejtë të kontaktojë me Autoritetin Kontraktues dhe Entin e Deleguar. Partneri Kryesor është i detyruar t'u vë në dispozicion Palëve të tjera të marrëveshjes, si në formë elektronike ashtu edhe në letër, dokumentet dhe informacionet që ka marrë nga Autoriteti Kontraktues dhe Enti i Deleguar dhe që u vijnë në ndihmë zbatimit dhe realizimit të aktiviteteve të projektit.
3. Partneri Kryesor duhet të sigurojë që zbatimi i projektit dhe zbatimi i të gjitha aktiviteteve të parashikuara në projekt të nisë në kohë në përputhje me Formularin e Aplikimit të hartuar bashkërisht me Partnerët e tjerë të projektit që është pjesë përbërëse e kontratës së grantit. Nëse është e nevojshme, Partneri Kryesor ka për detyrë të ndërmarrë veprime për të përditësuar afatet kohore të projektit.
4. Partneri Kryesor ka për detyrë:
 - a. Të sigurojë zbatimin me korrektësi të aktiviteteve të ndërmarrë në kuadër të projektit dhe të informojë menjëherë partnerët si dhe Autoritetin Kontraktues në lidhje me rrethanat që mund të kenë ndikim negativ në afatin kohor dhe objektin e aktiviteteve të përcaktuara në Formularin e Aplikimit;
 - b. Të bëjë të gjitha pagesat që detyrohet për zbatimin e projektit në tërësinë e tyre dhe në kohën e duhur;
 - c. Të konfirmojë lejueshmërinë e të gjitha kostove, përfshirë ato të faturuara nga partneri i projektit, nëse ka. Në rast të kostove të parregullta për shkak të mospërputhjes apo cilësisë së dobët të punimeve, të bazës materiale apo të shërbimeve të ofruara nga ofertuesit e përzgjedhur, përfshirë këtu edhe partnerin e projektit, Partneri Kryesor nuk do të pranojë dhe paguajë kosto të tilla.

- d. Të mbledhë të gjithë informacionin dhe dokumentet në përputhje me rregullat e monitorimit dhe raportimit të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues;
- e. Të raportojë tek Autoriteti Kontraktues dhe Enti i Deleguar për ecurinë e projektit dhe të aplikojë për rimbursimin e shpenzimeve të lejueshme të Projektit, duke paraqitur Kërkesat për Pagesë brenda periudhës së përcaktuar në Kontratën e Grantit;
- f. Të bëjë të mundur gjurmimin e auditit për identifikimin e çdo veprimi financiar duke ruajtur të gjithë dokumentacionin dhe të dhënat që lidhen me projektin e zbatuar;
- g. Të kthejë shumat e paguara padrejtësisht në kuadër të kontratës së grantit, brenda periudhës dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues;
- h. Të bashkërendojë masat e informimit që realizohen nga partnerët specifikë, masa që ndërmerren sipas marrëveshjeve të shkruara në Formularin e Aplikimit;
- i. Të sigurojë numrin e duhur të personelit të aftë dhe burimeve teknike të nevojshme për përmbushjen me efektivitet të detyrimeve që vijnë nga realizimi i funksioneve si Partneri Kryesor;
- j. Të informojë Autoritetin Kontraktues për çdo ndryshim në Marrëveshjen e Partneritetit për Zbatimin e Projektit.

§ 4. Të drejtat dhe detyrimet e Partnerëve

1. Çdo Partner ka për detyrë:
 - a. Të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin në kohë dhe të plotë të pjesës së tij të Projektit;
 - b. Të ndërmarrë të gjitha veprimet me qëllim që t'i bëjë të mundur Partnerit Kryesor të përmbushë detyrimet e përcaktuara në Kontratën e Grantit. Në lidhje me sa më sipër, çdo partner është i detyruar të japë të gjitha dokumentet dhe informacionin që kërkohet nga Partneri Kryesor sipas datave për t'i bërë të mundur atij të përmbushë detyrimet e përcaktuara në Kontratën e Grantit.
1. Partneri është tërësisht përgjegjësi i vetëm për zbatimin e detyrave të tij, në përputhje me përshkrimin e dhënë në Formularin e Aplikimit.
2. Çdo partner duhet të informojë menjëherë Partnerin Kryesor për rrethanat përkatëse që kanë ndikim në korrektësinë, afatin kohor, efektivitetin dhe plotësinë e aktiviteteve të tij.

3. Çdo partner ka për detyrë të paraqesë raporte tremujore për ecurinë në lidhje me detyrat e përcaktuara për të në Formularin e Aplikimit, brenda 5 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori.
4. Çdo partner mban përgjegjësi ndaj partnerëve të tjerë për dëmet që rezultojnë nga projekti apo për pasojat e dëmeve që vijnë si rezultat i detyrave dhe detyrimeve të deleguara te ai Partner në kuadër të Projektit.

§ 5. Ndarja e detyrave mes partnerëve

Aktivitetet që do të zbatohen nga Partneri Kryesor dhe partnerët e tjerë përcaktohen në Formularin e Aplikimit që është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje Partneriteti për Zbatimin e Projektit.

§ 6. Buxheti dhe pagesat

Zbatimi financiar do të bëhet vetëm nga Partner Kryesor i projektit sipas buxhetit të projektit, dokument që është shtojcë e kontratës së grantit.

§ 8. Informimi dhe Promovimi

Çdo dokument, botim, tabelë informimi, konferencë, apo trajnim që lidhet me Projektin duhet të përmbajë informacione për donatorët që bashkë-financojnë në kuadër të Programit të Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë. Gjatë zbatimit të projektit, në detyrat e informimit dhe promovimit nga Partnerët do të përdoren çdo herë dispozitat përkatëse të udhëzimeve për Komunikimin dhe Vizibilitetin të ofruara nga Autoriteti Kontraktues.

§ 9. Të drejtat e pronësisë intelektuale

Të gjithë partnerët duhet të bëjnë përpjekje që të gjitha produktet e Projektit të jenë pa kufizime për sa i përket mbrojtjes së këtyre të drejtave – brenda kufijve të kuadrit ligjor për pronësinë intelektuale. Të gjitha produktet dhe prodhimet në kuadër të këtij projekti do të jepen falas për individë dhe ente ligjore të interesuara pa asnjë paragjykim. Vënia në dispozicion vetëm për disa individë apo ente ligjore të caktuara është rreptësisht e ndaluar.

§ 10. Konflikti i interesit

1. Në këtë Marrëveshje, konflikti i interesave përfaqëson çdo rrethanë që ka ndikuar apo mund të ndikojë në zbatimin e Marrëveshjes nga palët, në mënyrë objektive dhe të paanshme. Të tilla rrethana mund të vijnë si rezultat i interesave ekonomike, preferencave politike apo kombëtare apo lidhjeve familjare.
2. Palët kanë detyrimin të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim shmangien e çdo konflikti interesi dhe të informojnë njëri tjetrin, deri në 5 (pesë) ditë nga evidentimi i këtij konflikti, për çdo rrethanë që ka sjellë apo mund të sjellë një



konflikt të tillë interesi. Çdo konflikt interesi që lind gjatë zbatimit të kontratës duhet t'i bëhet e ditur menjëherë nga Partneri Kryesor Autoritetit Kontraktues, i cili rezervon të drejtën të verifikojë rrethana të tilla dhe të marrë masat e duhura, sipas nevojës.

§ 11. Ndryshimet në marrëveshje

1. Çdo ndryshim e modifikim i kësaj Marrëveshjeje Partneriteti të Projektit do të bëhen vetëm në formën e një shtojce të marrëveshjes, dhe do të pranohet e nënshkruhet nga të gjitha palët e kësaj Marrëveshjeje Partneriteti të Projektit.
2. Nëse një nga partnerët tërhiqet nga zbatimi i mëtejshëm i Projektit, Partneri Kryesor dhe partner(të) i/e mbetur, nëse ka, do të veprojnë për të zbatuar deri në fund objektivat e projektit.

§ 12. Rregullimet e fundit

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe. Çdo palë merr një kopje të marrëveshjes së Partneritetit për Zbatimin e Projektit.

Aplikanti kryesor:

[Emri zyrtar i aplikantit kryesor]

[Mbiemri, emri dhe pozicioni i përfaqësuesit që nënshkruan]

[Vula]

[Firma]

Bashkë-aplikanti si Partner:

[Emri zyrtar i bashkë-aplikantit]

[Mbiemri, emri dhe pozicioni i përfaqësuesit që nënshkruan]

[Vula]

[Firma]

Partneri i Projektit si Partner:

[Emri zyrtar partnerit të projektit]

[Mbiemri, emri dhe pozicioni i përfaqësuesit që nënshkruan]

[Vula]

[Firma]



Shtojca: Formulari i Aplikimit